

Fjalimi i ministrit të Mbrojtjes, Vllado Misajlovski, në ceremoninë e përcjelljes së Komandës së SEEBRIG-ut

15 korrik 2026, Kazermë „Boro Menkov“ – Kumanovë

I nderuar Shef i Shtabit të Përgjithshëm,
I nderuar Komandant i Brigadës së Evropës Juglindore,
Të nderuar përfaqësues të vendeve pjesëmarrëse,
Të nderuar gjeneralë dhe oficerë,
Të nderuar përfaqësues të vetëqeverisjes lokale,
Të nderuar mysafirë,
Zonja dhe zotërinj,

Që në fillim të fjalës sime para jush, dëshiroj të theksoj se sot përfundon një kapitull i suksesshëm për Brigadën e Evropës Juglindore (SEEBRIG), gjatë të cilit vendi ynë pati nderin të jetë nikoqir i Komandës së kësaj Brigade.

Gjashtë vite arritjesh, besimi të forcuar, partneriteti dhe miqësisë të reja e të qëndrueshme. Ky është SEEBRIG-u! Një nga shembujt më të suksesshëm të bashkëpunimit rajonal në fushën e mbrojtjes, i ndërtuar mbi vlerat që të gjithë ne i ndajmë – besimin e ndërsjellë, partneritetin, solidaritetin dhe përgjegjësinë e përbashkët për paqen, stabilitetin dhe sigurinë në Evropën Juglindore.

Që nga themelimi i tij, SEEBRIG-u ka dëshmuar se shtetet mund të ndërtojnë me sukses besim të ndërsjellë dhe të punojnë së bashku. SEEBRIG-u është dëshmi se ky bashkëpunim nuk është vetëm një përcaktim politik, por edhe një instrument praktik dhe efikas për forcimin e sigurisë kolektive.

Sot, kur përballemi me sfida dhe kërcënime të sigurisë gjithnjë e më komplekse, më të paparashikueshme dhe të ndërlikura, të cilat nuk njohin kufij kombëtarë, një bashkëpunim i tillë është më i rëndësishëm se kurrë. Kjo kërkon koordinim, gatishmëri dhe një qasje të përbashkët. Në këtë kontekst, SEEBRIG-u mbetet një platformë e rëndësishme për dialog, mirëkuptim të ndërsjellë dhe bashkëpunim praktik ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore.

Në vitin 2016, vendi ynë pati nderin dhe përgjegjësinë të jetë nikoqir i Komandës së SEEBRIG-ut.

Prania e Komandës në Kumanovë gjatë gjashtë viteve të fundit përfaqësoi shumë më tepër sesa një detyrim organizativ apo logjistik. Krahës përkushtimit tonë të qartë dhe të palëkundur ndaj bashkëpunimit rajonal, sigurisë kolektive dhe respektimit të parimeve mbi

të cilat është themeluar SEEBRIG-u, prania e Komandës në Kumanovë mundësoi forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me vendet pjesëmarrëse.

Gjatë kësaj periudhe, edhe një herë dëshmuam se jemi një partner i besueshëm, i sigurt dhe aktiv, i gatshëm të marrë përgjegjësi dhe të kontribuojë konkretisht në paqen dhe sigurinë rajonale e ndërkombëtare.

Funksionimi i suksesshëm i Komandës së SEEBRIG-ut në Kumanovë u mundësua falë përkushtimit, profesionalizmit dhe bashkëpunimit të ngushtë të personelit nga të gjitha vendet pjesëmarrëse. Çdo pjesëtar i Komandës dha kontributin e vet në përmbushjen e misionit të saj. Si pjesë e Komandës së SEEBRIG-ut, ju punuat së bashku dhe ndërtuat marrëdhënie të bazuara në respekt, besim dhe një qëllim të përbashkët. Pikërisht këto marrëdhënie përbëjnë një nga trashëgimitë më të vlefshme të pranisë së SEEBRIG-ut në vendin tonë.

Me këtë rast, dëshiroj të theksoj edhe kontributin e rëndësishëm të qytetarëve të Kumanovës dhe të vetëqeverisjes lokale, të cilët ishin mikpritës të shkëlqyer dhe u ofruan mbështetje pjesëtarëve të Komandës së SEEBRIG-ut gjatë gjithë qëndrimit të tyre. Kumanova u bë një pjesë e rëndësishme e historisë së Brigadës dhe një vend që do të mbetet në kujtesën e shumë pjesëtarëve të Komandës dhe familjeve të tyre.

Zonja dhe zotërinj,

Edhe pse sot po e përcjellim Komandën e SEEBRIG-ut nga Kumanova, bashkëpunimi ynë vazhdon nga lokacioni i saj i ri në Stamboll, Republika e Turqisë. Kontributi ynë në aktivitetet e Brigadës vazhdon, sepse ky projekt rajonal ka rëndësi të jashtëzakonshme për të gjithë ne, për forcimin e bashkëpunimit dhe, mbi të gjitha, për stabilitetin dhe sigurinë në Evropën Juglindore.

Në fund, dëshiroj t'i falënderoj të gjithë pjesëtarët e Komandës së SEEBRIG-ut dhe të gjithë komandantët që shërbyen këtu në Kumanovë, përfshirë gjeneralin e brigadës Bilbil Bitri, për përkushtimin dhe kontributin e tyre. Ndërsa largoheni nga vendi ynë dhe vazhdoni detyrat tuaja profesionale, ju uroj të merrni me vete kujtime të bukura nga koha e kaluar këtu, nga njerëzit me të cilët punuat dhe nga miqësitë që krijuat.

Ju uroj shumë suksese në vazhdimin e përmbushjes së misionit të SEEBRIG-ut.

Ju faleminderit!